

Vendim nr. 186 datë 10.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 10.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 29 (A) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: AVENIR BALLVORA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 98, datë 14.10.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 02, datë 04.01.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-1490, datë 17.09.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 5, 17, 18, 41, 42, 119, 122, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); nenet 15, pika 2, 17, shkronja “c”, 26, 27, 58, pika 1, shkronjat “b”, “c”, “d” dhe “dh”, 61, pika 1, 71, 287, pika 1, 323, 324, 325, 432, pika 1 dhe 435, shkronja “a”, të Kodit të Procedurës Penale.

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi, në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë “Qufaj co.” sh.p.k., ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) kundër Shqipërisë në datën 26.07.1999. Me vendimin nr. 54268/00, datë 30.03.2005 (*vendimi nr.54268/00/2005*), *GJEDNJ*-ja, në çështjen “*Qufaj co*” sh.p.k. kundër Shqipërisë, ka vendosur, ndër të tjera, se shteti i paditur duhet t’i paguajë shoqërisë ankuese shumën e akorduar nga gjykata vendase prej 60,000,000 lekësh, duhet t’i akordojë shoqërisë ankuese 70,000 euro në lidhje me dëmin financiar dhe jofinanciar, të konvertueshme në valutën kombëtare të shtetit të paditur, sipas kursit të zbatueshëm në datën e shlyerjes, duhet t’i akordojë, gjithashtu, shoqërisë ankuese shumën prej 2,000 eurosh për kostot dhe shpenzimet gjyqësore.

2. Për zbatimin e vendimit të mësipërm të *GJEDNJ*-së Këshilli i Ministrave ka nxjerrë vendimin nr. 502, datë 30.06.2005 “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për çështjen “*Qufaj co*” sh.p.k. kundër Shqipërisë” (*VKM*-ja nr. 502/2005). Bazuar në *VKM*-në nr. 502/2005 dhe autorizimin e dhënë nga Ministria e Financave, për çelje llogarie, subjekti i interesuar, Raiffeisen Bank sh.a., ka hapur një llogari me emërtimin “Fonde të ngurtësuar për llogari të shoqërisë “*Qufaj co*” sh.p.k., ku janë hedhur 69,043,732.01 lekë. Me urdhrin nr. 3868/16 prot., datë 21.12.2005, ministri i Financave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të kërkuar për zbatimin e *VKM*-së nr. 502/2005, ka urdhëruar transferimin e shumës 69,043,732.01 lekë në llogarinë bankare të shtetasit. H.Q., ortak i vetëm i shoqërisë “*Qufaj co*” sh.p.k..

3. Kërkuesi, duke mos qenë dakord me urdhrin e ministrit të Financave për transferimin e shumës prej 69,043,732.01 lekësh në llogarinë bankare të shtetasit. H.Q. (president dhe ortak i vetëm i shoqërisë “*Qufaj co*” sh.p.k.), në përpjekje për të ndjekur rrugën ligjore për zbatimin e vendimit të *GJEDNJ*-së, ka paraqitur disa kallëzime penale, me pretendimin se mosekzekutimi i vendimit nr. 54268/00 të *GJEDNJ*-së (edhe nëse është ekzekutuar, nuk është ekzekutuar ndaj subjektit të legjitimuar, pasi shuma e lekëve duhet të depozitohet në llogarinë e shoqërisë “*Qufaj co*” sh.p.k) është pasojë e veprimeve korruptive ndër vite të qeverisë shqiptare, funksionarëve të lartë shtetërorë, funksionarëve të sistemit të drejtësisë, funksionarëve të Raiffeisen Bank në Shqipëri, si dhe të disa personave të tjerë. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se *VKM*-ja

nr.502/2005 nuk është ekzekutuar nga Raiffeisen Bank, e cila ka mashtruar duke prodhuar dokumente të cilat nuk pasqyrojnë të vërtetën.

4. Mbi kallëzimin e kërkesit, në datën 30.10.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë (*Prokuroria e Tiranës*) ka regjistruar procedimin penal nr. 8503 të vitit 2018 për veprat penale “Mashtrimi”, “Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura të vendimit të gjykatës” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 143, 320/a dhe 248 të Kodit Penal (KP), me të dëmtuar të veprës penale kërkesin.

5. Po kështu, mbi kallëzimin e kërkesit, në datën 21.01.2019, ish-Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë (*ish-Prokuroria e Krimeve të Rënda*) ka regjistruar procedimin penal nr. 12 të vitit 2019 për veprat penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë” dhe “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuara nga nenet 260 dhe 319/ç të KP-së. Ish-Prokuroria e Krimeve të Rënda ka vendosur, më pas, të shpallë moskompetencën lëndore dhe t’ia dërgojë aktet Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*). Kjo e fundit, në datën 20.12.2019 ka regjistruar procedimin penal nr. 122 të vitit 2019 për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” dhe “Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura të vendimit të gjykatës”, të parashikuara nga nenet 260, 319/ç dhe 320/a, paragrafi i dytë, të KP-së.

6. Gjithashtu, mbi kallëzimin e kërkesit, në datën 07.02.2019 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan (*Prokuroria e Elbasanit*) ka regjistruar procedimin penal nr. 271 të vitit 2019 për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 186/3 dhe 248 të KP-së. Prokuroria e Elbasanit ka shpallur moskompetencën lëndore për hetimin e procedimit nr. 271 të vitit 2019, duke ia dërguar aktet Prokurorisë së Posaçme, e cila në datën 03.04.2020, ka regjistruar procedimin penal nr. 104 të vitit 2020 për veprat penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” dhe “Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura të vendimit të gjykatës”, të parashikuara nga nenet 260, 319/ç dhe 320/a, paragrafi 2, të KP-së, me të dëmtuar të veprës penale kërkesin.

7. Në datën 01.04.2020 Prokuroria e Tiranës ka shpallur moskompetencën për procedimin penal nr. 8503 të vitit 2018 dhe ia ka dërguar aktet për kompetencë lëndore Prokurorisë së Posaçme. Kjo e fundit në datën 03.04.2020 ka vendosur bashkimin e dy procedimeve penale nr.

104 të vitit 2020 dhe nr. 122 të vitit 2019 në një procedim të vetëm nr. 122 të vitit 2019, për të njëjtat vepra penale të parashikuara nga nenet 260 dhe 319/ç dhe 320/a, paragrafi 2, të KP-së, me të dëmtuar kërkuesin, ndërkohë në datën 21.05.2020 ka vendosur bashkimin e akteve të procedimit penal nr. 8503/viti 2018 të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me aktet e procedimit penal nr. 122 të vitit 2019 për veprat penale të parashikuara nga nenet 260, 319/ç dhe 320/a, paragrafi 2, të KP-së.

8. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesë para Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) për pushimin e çështjes penale nr.122 të vitit 2019, pasi faktet e pretenduara nga kërkuesi si krime nuk ekzistojnë dhe si të tilla nuk parashikohen nga ligji si vepra penale.

9. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 98, datë 14.10.2022, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për pushimin e procedimit penal nr.122 të vitit 2019. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 02, datë 04.01.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Mbi rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1490, datë 17.09.2024, ka vendosur mospranimin e tij.

10. Në datën 08.05.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 23.05.2024. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

11.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

11.1.1. *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi të njëjtët gjyqtarë kanë marrë pjesë në disa gjykime që lidhen me shqyrtimin dhe vlerësimin e së njëjtës çështje dhe fakte, e konkretisht gjyqtarët I.P. dhe S.S., të cilët kanë marrë pjesë në tri vendimmarrje të Kolegjeve Penale, ku pavarësisht formës dhe pretendimeve lidhen me të njëjtën çështje. Po ashtu, gjyqtari S.B., i cili ka marrë pjesë në trupin

gjykues të dy kolegjeve që kanë shqyrtuar të njëjtën çështje në thelb dhe gjyqtarja M.M. e cila ka marrë pjesë në dy vendimmarrje.

- 11.1.2. *Parimit të sigurisë juridike dhe autoritetit të vendimeve përfundimtare*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar rekursin e kërkuarit, duke lënë në fuqi vendime që bien ndesh me një vendim përfundimtar të GJEDNJ-së. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë vendimet e mëparshme të gjykatave civile për pretendimet në çështjen objekt shqyrtimi, të cilat përbëjnë *res judicata* e si të tilla duhet të respektohen edhe nga gjykatat penale në vlerësimin e fakteve e provave.
- 11.1.3. *Parimit të barazisë së armëve* për mosvlerësimin dhe mosadministrimin e provave thelbësore, pasi si gjatë fazës hetimore edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në të gjitha shkallët e gjykimit, organet përkatëse kanë dështuar të marrin në shqyrtim ose të arsyetojnë për një sërë provash vendimtare e të verifikueshme. Për më tepër, prokuroria ka shkelur garancitë procedurale dhe ka komprometuar hetimin, sepse dosja hetimore e cila përmbante prova shumë të ndjeshme dhe konfidenciale, është përcjellë në mënyrë të paligjshme, dorazi, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.
- 11.1.4. *Së drejtës së njoftimit dhe të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*, pasi ndonëse ka paraqitur kërkesa të përsëritura si para prokurorisë ashtu edhe para organeve gjyqësore kompetente, për mungesën e njoftimit për çdo shtyrje të afatit të hetimit, ato janë neglizhuar në mënyrë sistematike, duke e privuar kërkuarin nga e drejta për të marrë pjesë në mënyrë efektive në hetim. Prokurorët kanë refuzuar qëllimisht të regjistrojnë kallëzimet penale me emrat e personave të identifikuar nga kërkuari si përgjegjës për shkeljet.
- 11.1.5. *Së drejtës për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar*, pasi i është ndaluar qasja në dosjen hetimore dhe në prova thelbësore të administruara nga prokuroria, duke pamundësuar përgatitjen e një mbrojtjeje efektive. Gjykata e Lartë ka vendosur në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit pa dëgjuar palët.
- 11.1.6. *Së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs. Ajo nuk ka shqyrtuar shkaqet e rekursit, por është mjaftuar me përsëritjen e argumenteve të Prokurorisë së Posaçme dhe të GJKKO-ve që kanë vlerësuar pa kritikë arsyetimet e prokurorisë.

- 11.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi mënyra sesi është trajtuar çështja e tij, duke moszbatuar vendimin e GJEDNJ-së, përbën një trajtim selektiv dhe diskriminues.
- 11.3. *Parimi i hierarkisë së akteve normative lidhur me respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare*, i garantuar nga nenet 116 dhe 122 të Kushtetutës, pasi vendimi i pranueshmërisë nga GJEDNJ-ja dhe vendimi përfundimtar i saj i datës 30.03.2005 në çështjen “*Qufaj co*” sh.p.k. kundër Shqipërisë njohin kërkuesin si përfaqësues legjitim, president dhe administrator të vetëm të shoqërisë dhe urdhëron shtetin shqiptar të paguajë dëmshpërblimin në favor të kësaj shoqërie. Organi i prokurorisë edhe pse është njohur me faktet, dokumentacionin dhe provat për shkeljen e Kushtetutës dhe devijimin nga vendimi i GJEDNJ-së, ka refuzuar të fillojë hetimet.
- 11.4. *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi shuma e njohur nga GJEDNJ-ja përbën pronë e si e tillë duhet të mbrohet si një e drejtë themelore. Mosdisbursimi i kësaj shume ndaj kërkuesit si përfitues i ligjshëm dhe transferimi i saj në mënyrë të kundërligjshme në favor të një personi tjetër, H.Q., përbën një formë shpronësimi arbitrar.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimit (locus standi) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Për sa i takon kriterit për legjitimimin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës individi është subjekt i kushtëzuar. Si i tillë, ai mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij

kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të. Kjo do të thotë se kërkuesi duhet të provojë legjitimitimin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 64, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Po kështu, Gjykata ka pranuar se një person nuk mund të ankohet për shkeljen e të drejtave të tij në procedura në të cilat nuk është palë edhe nëse është përfaqësues, aksionar dhe/ose drejtor i një shoqërie që ka qenë palë në ato procedura. Në këtë rast, interesat e tij përthithen nga interesat e shoqërisë, e cila duke qenë ajo subjekti i së drejtës mund të ankohet në Gjykatë për shkelje të të drejtave të lidhura me këto interesa (*shih vendimin nr. 33, datë 20.05.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në çështjen në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor penal në përfundim të të cilit është vendosur rrëzimi i ankimit ndaj vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 260 dhe 319/ç dhe 320/a, paragrafi i dytë, të KP-së, ndaj disa funksionarëve të lartë shtetërorë të sistemit të drejtësisë dhe atij bankar, si dhe ndaj disa personave të tjerë, për shkak të mosekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së. Sipas kërkuesit, gjykatat i kanë cenuar atij disa të drejta dhe parime të garantuara nga Kushtetuta (procesi i rregull ligjor, barazia përpara ligjit, marrëveshjet ndërkombëtare dhe prona), duke parashtruar se për shkak të veprimeve të të kallëzuarve shoqërisë “Qufaj co” sh.p.k. i është mohuar e drejta e shpërblimit nga dëmi i shkaktuar i njohur me vendimin e GJEDNJ-së, i cili është ekzekutuar në favor të shtetasit H.Q. (ortak i vetëm i shoqërisë). Ndërkohë kërkuesi, edhe pse ka qenë palë ankuese në procesin gjyqësor të kundërshtuar, në fakt rezulton të ketë qenë përfaqësues i shoqërisë në favor të së cilës ka vendosur GJEDNJ-ja dhe për llogari të së cilës është kryer ekzekutimi i vendimit nga institucionet shqiptare. Pra, vendimi i GJEDNJ-së dhe ekzekutimi i tij i ka takuar shoqërisë, e cila ka qenë palë në procedurat në fjalë, kurse kërkuesi nuk mbart të drejta dhe detyrime në raport me vendimmarrjen e GJEDNJ-së, sepse ato i takojnë shoqërisë. Kjo do thotë se interesat e kërkuesit, në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë, janë përthithur nga kjo e fundit, e cila është subjekti i së drejtës që mbart interesa për ekzekutimin e vendimit të dhënë në favor të saj. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae* në aspektin substancial për t’iu drejtuar Gjykatës.

16. Për sa më lart, Kolegji çmon se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjerë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

17. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkesit nuk plotëson kriteret ligjore paraprahe për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.